




Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel
Zyra e Prokurimit
Nr 03/ 24
Datë : 30.03.2023.

KONTRATË PROKURIMI NR 19
62500-23-2024-2-3-6/C653

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"ALBI & B " SH.P.K. me seli në Prizren me nr.biznesi: 810096760, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

HARTIMI I RAPORTEVE TË VNM-së PËR LOKACIONET E DEPONIVE NË FSHATRA TË KOMUNËS SË MALISHEVËS me numër identifikues:

Nr1 i prokurimit	62500-23-2024-2-3-6
Nr i brendshëm	62500-23-024- 2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve: **DO TË BËHET HARTIMI I RAPORTEVE TË VNM-së PËR LOKACIONET E DEPONIVE NË FSHATRA TË KOMUNËS SË MALISHEVËS.**

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë : **7,200.00€ (shtatë mijë e dyqindë euro) Euro.**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **SHQIPE** në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Albion Bytyqi
Pozita:	Menagjer i Prokurimit	Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.03/23	Data:	30.03.2023
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës : 62500-23-2024-2-3-6/C653

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Gjuha përdorur	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : Gjuha Shqipe.
Fillimi Shërbimeve	3	Kontrata hynë në fuqi me 29.03.2023.
Përfundimi shërbimeve	4	Hartimi i raporteve të VNM-së për lokacionet e deponive në fshatrat e Komunës së Mlaishevës do të kryhen brenda 50 ditëve.
Menaxheri i kontratës	12.3	Menaxhimin e kontratës dota e bëjë zyrtari i DSHP-së z.Kujtim Stolliqi caktuar nga ZKA i AK-së.
Vendi i realizimit të shërbimeve		Në katër lokacione në fshatrat Panorc, Kijevë, Banjë dhe Drenoc.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Nuk aplikohet.
Kryerja e shërbimeve nga OE	15	Hartimi i raporteve të VNM-së për lokacionet e deponive në fshatrat e Komunës së Mlaishevës duhet të kryhen në përputhje të plotë me specifikacionin e ofertës. Nese Hartimi i raporteve të VNM-së për lokacionet e deponive në fshatrat e Komunës së Mlaishevës nuk kryhen në cilësi dhe sasi nga ana e OE dhe në përputhje të plotë me specifikacionin e ofertës të gjitha shpenzimet e bëra do të bien në llogari të OE.
Përgjegjësia e OE	17	OE është përgjegjës për të gjitha dëmet materiale të cilat mund të shkaktohen gjatë kryerjes së shërbimeve nese OE është fajtor.

Obligimet e AK		Obligohet AK që mbasi ta e pranon raportin për pranim të raporteve të VNM-së për lokacionet e deponive në fshatrat e Komunës së Mlaishevës nga zyrtari z.Kujtim Stolliqi i caktuar nga ZKA i AK-së dhe faturën nga OE të ia paguaj shumën sipas nenit 2 dhe 2.1 të kësaj kontrate. AK e ruan të drejtën që ta e ndërprej kontratën me OE për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe nese nuk iu përmbahet plotësisht kushteve të kontratës.
Pagesa nga ana e AK-së	18	Pagesa OE do të i kryhet në bazë të raportit të zyrtarit të DSHP-së z.Kujtim Stolliqi i caktuar nga ZKA i AK-së për menagjim të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për ndermjetesim pranë Ministris së Drejtësis.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Specifikacioni për Hartimin e Raporteve të VNM-së

Nr.	EMËRTIMI I POZICIONEVE	Njësia matese	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH
1	Rregullimi i dokumentacionit teknik, përkatësisht marrjen Pelqimeve Mjedisore për tri deponit dhe një pikë të transferit të mbeturinave në katër lokacione të ndryshme në Komunën e Malishevës.	COPE	4	1800	7,200.00 €
				TOTALI:	7,200.00 €

Vrejtje : Vlera finaciare përfshinë rregullimin dhe përmbushjën e këtyre obligimeve :

- Hartimin e raportit të Vlersimit të Ndikimit në Mjedis kompletimi i dosjes për aplikim.
- Pagesën e Aplikimit në MMPHI.
- Pagesën për shpallje në gazetë zyrtare mbajtja e debatit publik.
- Rregullimin e katër situacioneve të terenit nga një zyrë gjeodezike e licencuar.

A. Bytygu